

Raporti i shqyrtimit të vërejtjeve dhe komenteve për Planin Rregullues të Hollësishëm për zonën e lagjes Kalabria- pjesa e kolektorit, sipas UA MMPH-Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor si dhe sipas UA MAPL-NR.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna,



Nr.	Emri, mbiemri i parashtruesit	Vërejtje, propozim, sugjerim, kërkesë	Arsyetimi i grupit punes
1.	Një Grup i banorëve të lagjes Kalabria	Një Grup i banorëve të lagjes Kalabria, shprehin dëshirën që lumi të mbyllet, si në rrugën Shefqet Shkupi?	1. Rrjedha e lumit-prockës së Matit, do të mbetet e hapur, si kontinuitet i planeve tjera rregulluese, "Prishtina e Re-Zona Perëndim" dhe "Prishtina e Re-Zona Qendër".
2.	Banor i lagjes Kalabria (anonim)	Banor i lagjes Kalabria (anonim), i ka disa pyetje: 1. Treni i planifikuar a do të jetë ne formë të metros (nëntokësore), apo mbi tokë? 2. Treni a e ka zëvendësuar rrugën nga 4 korsi në 2 korsi? 3. Lumi a do të jetë i hapur apo i mbyllur? 4. Sa korsi do të jetë rruga? 5. Rekomandon rrugë me 4 korsi.	1.Treni i planifikuar do të qarkulloj mbi tokë; 2.Treni nuk e zëvendëson rrugën nga katër korsi në dy korsi, rruga mbetet me katër korsi; 3. Rrjedha e lumit-prockës së Matit, do të mbetet e hapur, si kontinuitet i planeve tjera rregulluese, "Prishtina e Re-Zona Perëndim" dhe "Prishtina e Re-Zona Qendër"; 4.dhe 5. Rruga do të jetë me katër korsi;
3.	Pronarë i parcelës kadastrale 2855/21	Pronarë i parcelës kadastrale 2855/21, ankohet në koeficientin e ndërtimit	Parcela kadastrale nr.2855/21 ZK Prishtinë, nuk figuron ne geoportal, por sipas një kopje të planit të dorëzuar me ankesa tjera, shihet se ndarjet e reja te kësaj parcele të cilat përfshihen në këtë PRRH janë 2855-22 , 2855-23 dhe një pjesë nga parcela kadastrale 2855-29 ZK Prishtinë. Sa i përket ankesës për koeficient ndërtimi (nëse bëhet fjalë për ndarjet e lartëcekura), ankesa nuk miratohet, koeficienti i ndërtimit mbetet i njëjtë, për arsye se planifikimi për këtë zonë është bërë duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja,

			gjelbërimi, etj. andaj koeficienti i ndërtimit 2.4, është maksimumi që është arritur për këtë zonë.
4.	Qemajl Pozhegu/044/430-455/pozhegubrothers@gmail.com, nga kompania "Pozhegu Brothers"	Qemajl Pozhegu, nga kompania "Pozhegu Brothers", ka kërkesë që objekti i planifikuar "Ndërtesa "A7"-faza 2 e ndërtimit të ketë etazhitet 2B+P+9, si dhe të lejohet dalja me konzollë (komplet ndërtesa në etazhet prej katit 1 deri në katin 9), deri në 1,20m jashtë vijës ndërtimore të rrugës së planifikuar me Plan. (bashkangjitur skica me zgjidhje urbane të 2 projekteve Pozhegu Brothers&Nartel Ex-in.	Miratohet kërkesa për etazhitet të ndërtesës P+9 dhe dalja me konzollë prej katit të parë e më lartë.
5.	Nehat Begolli	Nehat Begolli (pronarë i tokës), për parcelat kadastrale P-10080-12, P-10080-6: Ka kërkuar që objekti i planifikuar dhe i emërtuar "Ndërtesa C" të ketë etazhitet 2B+P+9, si dhe të lejohet dalja me konzollë (komplet ndërtesa në etazhet prej katit 1 deri në katin 9), deri në 1,20m jashtë vijës ndërtimore të rrugës së planifikuar me Plan. (bashkangjitur skicat)	Miratohet kërkesa për etazhitet të ndërtesës P+9 dhe dalja me konzollë prej 1.5m, prej katit të parë e më lartë.
6.	Nehat Begolli, 044-707-073 dhe "Nartel Ex-in", 049-188-092, 044-885-894,;	Nehat Begolli, pronar i parcelave si në vijim: P-10080-7, P-10080-10, P-10080-12, P-07642-5 dhe "Nartel Ex-in": 1)Kërkojnë të kontrollohen llogaritjet e parcelës për koeficient ndërtimi, pasi që m2 të Planit nuk mund të realizohen në etazhitet P+8 por vetëm në P+9, si dhe kërkon të shtohet mbindërtimi prej 1 etazhe në ndërtesën A4(në pjesën jugore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratohet kërkesa për etazhitet të ndërtesës P+9; 2. Nuk miratohet, sepse parcela gjendet jashtë kufirit të përcaktuar të këtij plani rregullues, si parcele e veçantë;

		<p>të bllokut 3, d.m.th. nga ana e kolektorit (e ndërtuar me leje ndërtimi);</p> <p>2) Po ashtu kërkohet që në këtë etazhitet të përfshihet edhe pjesa e parcelës me nr.10080-10 e cila ka sip.67m²;</p> <p>3) Në pjesën lindore të bllokut 3 (në afërsi me lokacionin e shkollës së planifikuar), prej vijës ndërtimore kërkohet të lejohet konzolla prej 1.2m nga kati i parë;</p> <p>4) Në paragrafin Kushtet Ndërtimore, ku ceket se ndërtesat që shtrihen përgjatë trasesë së rrugës së planifikuar-kolektorit që së paku 2 kate të jenë afarizëm, kërkohet të ndryshohet në 1 ose 2 etazhe për bllokun 3, pasi që më shumë se 50% e bllokut është e ndërtuar me një kat afarizëm, dhe vjen deri te ndryshimi i lartësisë së etazhës dhe shëmtimi në aspektin arkitektonik;</p> <p>5) Vija e rrugës në pjesën lindore të bllokut 3 (në afërsi të lokacionit të shkollës së planifikuar), të jetë e drejtë në mënyrë që të mos haset në problem gjatë pozicionimit dhe projektimit të ndërtesave në vijën ndërtimore;</p> <p>Vërejtjeve ju është bashkangjitur edhe një prezantim grafik i parcelave të cilat kanë hy në ndërtim, po ashtu janë të paraqitura edhe llogaritjet e sipërfaqes ndërtuese me koeficient, parcelat e shpronësuara, parcelat të cilat do të shqyrtohen si dhe fletat poseduese dhe kopjet e planit të parcelës e cila ka qenë si një e vetme dhe ndryshimin e saj në parcela të cilat janë ri formësuar.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 3. Miratohet konzolla prej 1.5m, në të gjitha anët e ndërtesave të planifikuara nga kati i parë e më lartë; 4. Miratohet kërkesa me kusht që së paku, përdhesa të jetë afarizëm; 5. Vija ndërtimore në zonën për ku e keni bërë përshkrimin, sipas këtij Plani, është e drejtë;
7.	<p>Ibish Asllani, 044-162-549 dhe tel. i djalit 044-475-206,</p>	<p>Ibish Asllani, pronarë i parcelës kadastrale nr.2854-0-parcela në tërësi, pyetja është lidhur me pronësinë dhe gjendjen e planit rregullues të hollësishëm "Pjesa e kolektorit"-kërkesa e paqartë;</p>	<p>Parcela kadastrale nr.2854-0 ZK Prishtinë, e cila sipas gjendjes së re kadastrale mban numrin 10158-1, nuk trajtohet me këtë plan dhe kjo parcelë është në pronësi komunale.</p>

8.1	Magbule Breznica, 044-661-019	Kërkohet që me këtë plan, të trajtohet edhe parcela kadastrale nr.2855/21, pasi që me Planin e 2005 kanë qenë të diskriminuar, destinimi të ndryshohet nga gjelbërimi në ndërtim;	Ankesa nuk aprovohet, kufiri I PRRH nuk mund të zgjerohet, pasi që ajo është aprovuar si e tillë nga Kuvendi Komunal, parcelat tjera do të trajtohen me Plane tjera të cilat janë në procedurë të hartimit si PZHK dhe Harta Zonale e Prishtinës.
8.2	Isa Krasniqi, 044-408-242	Kërkohet që të shqyrtohet edhe parcela kadastrale nr.2855/21, dhe të mos diskriminohet, ceket se nuk do ta pranojnë shpronësimin pa u rregulluar plani edhe në parcelën e lartcekur;	Ankesa nuk aprovohet, kufiri I PRRH nuk mund të zgjerohet, pasi që ajo është aprovuar si e tillë nga Kuvendi Komunal, parcelat tjera do të trajtohen me Plane tjera të cilat janë në procedurë të hartimit si PZHK, ose është marrë Vendimi për hartimin e tyre si Harta Zonale e Prishtinës
8.3	Hamdi Jupolli, 044-810-847	Hamdi Jupolli, bashkëpronarë në parcelën 2855/21, kërkon që të trajtohet edhe kjo parcelë njëjtë si të tjerat në këtë lagje e jo të kthehet në gjelbërim;	Ankesa nuk aprovohet, kufiri I PRRH nuk mund të zgjerohet, pasi që ajo është aprovuar si e tillë nga Kuvendi Komunal, parcelat tjera do të trajtohen me Plane tjera të cilat janë në procedurë të hartimit si PZHK, ose është marrë Vendimi për hartimin e tyre si Harta Zonale e Prishtinës
8.4	Osman Krasniqi	Osman Krasniqi, për parcelën kadastrale nr.2855/21, kërkon të trajtohet me Planin Rregullues Urban dhe t'i jepet mundësia e ndërtimit-ndërtim i lartë;	Ankesa nuk aprovohet, kufiri I PRRH nuk mund të zgjerohet, pasi që ajo është aprovuar si e tillë nga Kuvendi Komunal, parcelat tjera do të trajtohen me Plane tjera të cilat janë në procedurë të hartimit si PZHK, ose është marrë Vendimi për hartimin e tyre si Harta Zonale e Prishtinës
8.5	Kadrush Jupolli,	Poashtu ankohet për mos përfshirjen e parcelës kadastrale nr.2855-21, në këtë plan rregullues, dhe kërkon që kjo parcelë të jetë zonë ndërtimore e jo gjelbëruese;	Ankesa nuk aprovohet, kufiri I PRRH nuk mund të zgjerohet, pasi që ajo është aprovuar si e tillë nga Kuvendi Komunal, parcelat tjera do të trajtohen me Plane tjera të cilat janë në procedurë të hartimit si PZHK, ose është marrë Vendimi për hartimin e tyre si Harta Zonale e Prishtinës



9.1	Milaim Abdullahu, 049-136-607,	Ankesa ka të bëjë me planifikimin e shkollës fillore në parcelën kadastrale 7643-0, për të cilën ankuesi, pretendon se është pronë e tij, e blerë nga i ndjeri Bejtë Canolli dhe trashëgimtarët Florim dhe Lumnije Canolli, ku ka ndërtuar edhe shtëpinë në vitin 2003. Kërkon që deri në Vendimin përfundimtar të gjykatës, të ndërprehen të gjitha aktivitetet e ndërtimit;	Në regjistrat e pronave të drejtorive përkatëse, si pronarë i parcelës kadastrale nr.7643-0 ZK Prishtinë figuron P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë.
9.2	Agim dhe Hamdi Abdullahu, 044-257-144	Ankesa ka të bëjë me parcelën kadastrale nr.7643-0, ku ankuesi cek se e ka blerë nga Bejt Canolli dhe trashëgimtari i tij Florim Canolli me të cilin ka kontratë shitblerjeje dhe në këtë parcelë e ka ndërtuar shtëpinë në vitin 2001, ku jeton edhe tani. Ankuesi cek se pastaj ka filluar procedura gjyqësore në mes të Florim Canollit dhe Komunës së Prishtinës, e cila ende nuk ka përfunduar;	Në regjistrat e pronave të drejtorive përkatëse, si pronarë i parcelës kadastrale nr.7643-0 ZK Prishtinë figuron P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë.
9.3	Arjanit Vllahu, 044-595-585	Ankesa është bërë për parcelën kadastrale nr.7643-0, ku ankuesi cek se e ka blerë nga Florim Canolli me të cilin ka kontratë shitblerjeje dhe fletat poseduese, ku në bazë të fletës poseduese deri në vitin 2010 kjo parcelë ka figuruar në emër të Florim Canollit. Në këtë parcelë e ka ndërtuar shtëpinë në vitin 2000. Ankuesi cek se banorët në këtë parcelë me 7 shtëpi janë ankuar dhe lënda është në procedurë gjyqësore;	Në regjistrat e pronave të drejtorive përkatëse, si pronarë i parcelës kadastrale nr.7643-0 ZK Prishtinë figuron P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë.

9.4	Florim Canolli dhe familja Canolli, 049 787-004, 044 677-480	Ankesa është përsëri për parcelën kadastrale nr.7643-0, ku ankuesi i ka bashkangjitur dokumentet dhe sqarimin me shpjegim të historiatit të kësaj parcele;	Në regjistrat e pronave të drejtorive përkatëse, si pronarë i parcelës kadastrale nr.7643-0 ZK Prishtinë figuron P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë.
9.5	Selim dhe Emine Bërbatovci, 044-262-873, 044-530-839	Ankesa përsëri ka të bëjë me parcelën kadastrale nr.7643-0, ku ankuesit cekin se parcelën e kanë blerë nga Alush Bejt Canolli, me të cilin kanë kontratë shitblerjeje dhe në këtë parcelë e kanë ndërtuar shtëpinë në vitin 2001, ku jetojnë edhe tani. Kërkojnë që Komuna e Prishtinës të ndërroj destinimin nga Shkollë fillore në banim kolektiv, gjithashtu t'ju mundësohet qasja në rrugën kryesore te lumi, e cila do të ndërtohet. Ankuesi cek se çështja është në procedurë gjyqësore, e cila ende nuk ka përfunduar dhe derisa të mos zgjidhet rasti Komuna të mos ndërmerre asnjë veprim. Bashkangjitur dokumentacioni për vërtetimin e pronësisë.	Në regjistrat e pronave të drejtorive përkatëse, si pronarë i parcelës kadastrale nr.7643-0 ZK Prishtinë figuron P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë.
9.6	Ankesa nga familja Avdullahu, 044-393002, 049-626617,	Ankuesit shprehin shqetësimin lidhur me planifikimin ne parcelën kadastrale nr.7643, duke përshkruar se këtë parcelë e kanë blerë në vitin 1996 nga Avdyl Canolli, kurse shtëpinë e kanë ndërtuar në vitin 1999. Ankuesi cek se çështja është në procedurë gjyqësore, e cila ende nuk ka përfunduar dhe derisa të mos zgjidhet rasti Komuna të mos ndërmerre asnjë veprim.	Në regjistrat e pronave të drejtorive përkatëse, si pronarë i parcelës kadastrale nr.7643-0 ZK Prishtinë figuron P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë.

9.7	Ankesë nga familja Tërmkolli, 044-111-327,	Ankuesi cek se janë pronarë të parcelës kadastrale nr.7643-0, të blerë nga Abdyl Canolli në vitin 1999. Nuk kanë pasur asnjë problem para lufte, po pas viteve të çlirimit ka pasur problem dhe shqetësime, nuk janë të interesuar ta japim truallin dhe e lusin Komunën e Prishtinës ta rishqyrtoj Planin.	Në regjistrat e pronave të drejtorive përkatëse, si pronarë i parcelës kadastrale nr.7643-0 ZK Prishtinë figuron P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë.
10.	Muharem Hondozi, 044-426-026,	Ankuesi është pronarë i parcelës kadastrale me numër P-71914059-07637-3 ZK Prishtinë, vendi i quajtur te lumi. E kundërshton draft dokumentin për Planin Rregullues të Hollësishëm për Zonën e lagjes Kalabria –pjesa e kolektorit, të hartuar nga DPSZHQ. Propozon të mbulohet procka e Matit dhe të vendoset rruga mbi kolektor dhe mos të dëmtohet vetëm Muharem Hondozi me familje, po të shkohet në dy anët e prockës së Matit. Ankuesi më tutje cek se është peng i pronës së vet prej v.2005. Përpos mbulimit të prockës së Matit, dhe rruga të vendoset mbi kolektor, ankuesi cek se kundërshton çdo gjë që e dëmton pasurin e tij. Bashkangjitur me ankesë, është prezantuar edhe dokumentacioni i pronësisë dhe ankesa e shkruar në formë më të zgjeruar.	Ankesa është aprovuar pjesërisht, duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja, gjelbërimi, etj.
11.	Rexhep Qerimi, kërkesë e protokoluar me nr.04-016/01-292282/19 dt.29.11.2019, tel.044233017	Kërkuesi është pronar i parcelave kadastrale me numër 02857-8, 02859-1/2/3 ZK Prishtinë. Kërkesa ka të bëjë me: 1. Për të zbutur etazhitetin e planifikuar prej P+15 në P+10, kërkon rritjen e Indeksit të shfrytëzimit të parcelës për pjesën afariste (përdhese dhe kat), prej 0.4 sa është e planifikuar në 0.6; 2. Për shkak të mbingarkesës se këtij blloku, kërkon qe te lejohet qe te largohet nga ky bllok objekti per arsim parashkollor, ose nëse obligohet te	1.Kërkesa për rritjen e Indeksit të shfrytëzimit të parcelës prej 0.4 në 0.6 miratohet, sipas gabariteve dhe etazhitetit si në pjesën grafike te Planit; 2.Nuk miratohet;

ndërtohet, te jete objekt privat pasi qe edhe vet shtrihet ne prone private.

3. Gjithashtu kërkon rritjen e koeficientit prej 2.4 ne 3.0, si rezultat i rritjes se vlersimit te patundshmërive me vite prej Planit Rregullativ Kalabria te aprovuar nga 2008 e deri me sot.

3. Kërkesa nuk miratohet, koeficienti i ndërtimit mbetet i njëjtë, për arsye se planifikimi për këtë zonë është bërë duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja, gjelbërimi, etj.andaj koeficienti i ndërtimit 2.4, është maksimumi që është arritur për këtë zonë.

Komisioni me dt.16.09.2020, sipas Vendimit 14-020/02-0094087/19 dt.24.04.2019 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Vendimit nr.14-020/04-0177889/20 me dt.30.09.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.14/020/070094087/19 dt.24.04.2019, në përbërje:

Anita Osmani, kryesuese.....

Florim Krasniqi, anëtarë.....

Arta Sylejmani, anëtarë.....

Sazan Raskova, anëtarë.....

Fatbardha Mehmetukaj, anëtarë.....

Kushtrim Domaneku, anëtarë.....

Merita Rushiti, anëtarë.....

Avdurrahman Krasniqi, anëtarë.....

Makfired Abdullahu, anëtarë.....

Daut Humolli, anëtarë.....

pushim të lëshonit

